



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY GJILAN

Adresa: Rr. *Zija Shemsiu*, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel. +381 (0) 280390112

Ref. nr.

PLANI STRATEGJIK I UKZ 2017-2022
(rishikuar në vitin 2020)

Gjilan, maj 2017 / Rishikuar 2020

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

FJALA E REKTORIT. Prof. Asoc. Bajram Kosumi, Rektor

PROCESI I HARTIMIT, RISHIKIMIT DHE METODOLOGJIA

1. Procesi i Hartimit të Strategjisë Zhvillimore 2017-2022 në vitin 2017
2. Procesi i Rishikimit në vitin 2020
3. Metodologjia

KAPITULLI I: KONTEKSTI I ARSIMIT TË LARTË

1. Sistemi arsimor në Republikën e Kosovës dhe Zona Europiane e Arsimit të lartë: historia dhe gjendja aktuale
2. Organizimi dhe struktura e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës
3. Sistemi i akreditimit në Republikën e Kosovës
4. Historiku i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan
5. Organizimi dhe funksionimi i UKZ-së

KAPITULLI II: VIZIONI, MISIONI, VLERAT

1. Vizioni
2. Misioni
3. Vlerat themelore
4. Gjendja e arsimit në UKZ

KAPITULLI III SWOT ANALIZA

KAPITULLI IV: QEVERISJA DHE ORGANIZIMI

KAPITULLI V: OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. UNIVERSITETI, SHOQËRIA DHE TREGU I PUNËS TË JETË NJË CIKËL DHE PROCES I NDËRLIDHUR
2. AVANSIMI I PROGRAMEVE STUDIMORE NË TRI NIVELET E STUDIMEVE
3. TË RRITET GJITHËPËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË AKTIVITETET UNIVERSITARE DHE KOMUNITARE
4. BURIMET NJERËZORE- ZHVILLIMI I MËTEJMË I BURIMEVE NJERËZORE
5. SISTEMI I SIGURIMIT TË CILËSISË- SIGURIMI DHE NGRITJA E CILËSISË

6. PËRMIRËSIMI DHE PROMOVIMI/PËRKRAHJA E PUNËS KËRKIMORE SHKENCORE
7. PROFILIZIMI I UKZ-SË
8. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR
9. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS ADMINISTRATIVE, HAPSINORE, FINANCIARE DHE TË IT
10. FINANCIMI

KAPITULLI VI : MONITORIMI DHE RAPORTIMI

KAPITULLI VII: MONITORIMI DHE RAPORTIMI

LISTA E SHKURTESAVE

AKA	Agjensioni Kosovar Akreditimit
ALUMNI	
ATEE	Asociacion for Teacher Education in Europe
BE	Bashkimi Evropian
BIK	Bordi Industrial Këshillëdhënës
BUA	Ballkan University Asociacion
ENQA	Asociacioni evropian për sigurimin e cilësisë ne arsimin e lart
EQAR	Regjistri Sigurimit të Cilësisë Evropiane për Arsimin e Lartë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
INQAAHE	Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë ne Arsim te Lartë
KB	Këshilli Botues
KD	Këshilli Drejtues
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
KQSC	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
PS	Plani Strategjik
QPM	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
ZZHK	Zyra për Zhvillimin e Karrierës
RKS	Republika e Kosovës
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
TI	Teknologjia e Informacionit
UKZ	Universiteti KADRI ZEKA
USAID	Ndihma e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar ZIK
ZZHAC	Zyra për Zhvillim Akademi dhe Cilësisë

Shkurtesat nuk jane krejt ne perputhje me dokumentin. Te harmonizohen!

LISTA E TABELAVE

- Tabela nr. 1: Numri i fakulteteve, i programeve studimore dhe titulli që fitohet (UKZ)
- Tabela nr. 2: Numri total i studentëve të regjistruar në UKZ nga viti 2013 deri në vitin 2020 (UKZ)
- Tabela nr. 3: Numrin e stafit akademik në raport me studentët në vitin 2020. (UKZ)
- Tabela nr. 4: Organogrami i organizimit dhe udhëheqjes së UKZ (UKZ)
- Tabela nr. 5: Buxheti tre vjecar i UKZ i projektuar. (Qeveria e Kosovës)
- Tabela nr. 6: Buxheti tre vjecar i UKZ i realizuar. (Qeveria e Kosovës)
- Tabela nr. 7: Kërkesat e UKZ për buxhet shtesë ndaj Qeverisë së Kosovës. (UKZ)
- Tabela nr. 8: Të hyrat vetanake 2018/2019/2020 (UKZ)
- Tabela nr. 9: Të hyrat nga projektet ndërkombëtare (2018, 2019, 2020). (UKZ)
- Tabela nr. 10: Orientimi i buxhetit drejt objektivave strategjike. (UKZ).

FJALA E REKTORIT

Prof. Asoc. Bajram Kosumi, rektor

Katër vjet pas themelimit, kur tashmë kishim të diplomuarit e parë me diplomën e Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Universiteti e hartoi Planin Strategjik, në vitin 2017.

Ky Plan Strategjik përfshin periudhën pesëvjeçare 2017-2022 dhe është hartuar në përputhje me *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Qeverisë së Kosovës*, me *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021* dhe me *Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019*.

Në vitin 2020 u shtrua nevoja imediate për rishikimin në disa segmente të Planit Strategjik, pasi shumica e objektivave strategjike dhe objektivave specifike të parapara në vitin 2017 tashmë ishin përmbushur ose ishin në proces të përmbushjes, prandaj kërkohej rishikimi dhe plotësimi i Planit Strategjik sidomos me objektiva specifike.

Ky Plan Strategjik përfshinë dy procese: procesin e hartimit të tij në vitin 2017 dhe procesin e rishikimit në vitin 2020.

Thelbi i Strategjisë mund të përfshihet në pesë pika:

1. Finalizimi i tërësishëm i zhvillimit të Universitetit (qëndrueshmëri financiare, tri nivele të studimit, pesë njësi akademike);
2. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore, administrative dhe hapësirore për Universitetin;
3. Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe e hulumtimeve;
4. Orientimi i programeve studimore kah kërkesat e tregut të punës dhe orientimi i hulumtimit shkencor kah nevojat e shoqërisë dhe të ekonomisë;
5. Ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të misionit të Universitetit për forcimin e mendimit kritik dhe studimet e thelluara shkencore.

Për një universitet të ri dhe në konsolidim e sipër, qartësimi i objektivave strategjike, i objektivave specifike dhe i veprimeve që duhet ndërmarrë për realizimin e atyre prioriteteve është një prej veprimeve më të rëndësishme. Cdo fillim vit, nga viti 2018, është hartuar Plani i Veprimit, i cili i ka operacionalizuar deri në detaje veprimet për realizimin e objektivave strategjike. Nga viti 2019, në cdo fundvit kalendarik është bërë mbikqyrja e zbatimit të Planit Strategjik dhe Këshilli Drejtues ka miratuar raportin e mbikqyrjes. Ndërsa në vitin 2020 është hartuar Rregullorja për Mbikqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik dhe është formuar Komisioni për të bërë këtë mbikqyrje. Kjo është mënyra e duhur për ta orientuar universitetin kah profili i synuar universitar dhe për ta shndërruar atë në një prej shtyllave të rëndësishme të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe më gjerë.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

“Universiteti ynë është mundësia më e mirë për krijimin dhe avansimin e vlerave themelore njerëzore, për çdo kohë dhe në çdo hapësirë.”

Ky është vizioni ynë.

Universiteti është mundësia më e mirë për një shoqëri që t'i edukojë dhe t'i bëjë të përgjegjshëm anëtarët e vet për vlerat e përbashkëta shoqërore: për lirinë, parimet e demokracisë, mirëqenien ekonomike, paqen sociale dhe vlera të tjera humaniste, të cilat

qëndrojnë në themel të një shoqërie me vlera të larta. Këto vlera duhet të maten me të kaluarën tonë, me të tashmen dhe me të ardhmen.

Jeta e ardhme e shoqërisë sonë, dija, shkenca dhe edukimi, ekonomia e ardhme, mirëqenia, demokracia dhe pozita në arenën ndërkombëtare varen nga mënyra se si rrjedhin sot proceset në universitete dhe në shkolla të tjera. Universiteti do të edukojë dhe mësojë studentët e sotëm me përgjegjësitë publike të ardhme. Ai do të mësojë studentët se përmes hulumtimit shkencor shoqëria njerëzore mund të mbijetojë dhe të jetojë në harmoni me natyrën tokësore dhe hapësirat kosmike. Ai e edukon shoqërinë për një jetë në paqe dhe në mirëqenie. Universiteti përgatitë lidërshpinin e shoqërisë sonë në të gjitha fushat.

Për ta kryer këtë mision të vetin Universiteti duhet të përshtatet me zhvillimet më të reja në shkencën dhe në tregun kombëtar e ndërkombëtar. Janë dy elemente thelbësore që e përcaktojnë rrugën e këtij zhvillimi:

- teknologjia informative, e cila është bërë në shekullin XXI promotori i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror;
- procesi i globalizmit, i cili tashmë ka ndodhur dhe po ndodhë para syve tanë, larg ndikimeve politike e të subjekteve: interneti dhe produktet e tij e kanë bërë shoqërinë më globale se kurrë më parë në historinë e njerëzimit, ky proces tashmë ka ndodhur, pavarësisht anëve të mira dhe të këqija, dhe ne vetëm duhet të përshtatemi dhe ta bëjmë këtë proces sa më humanist.

Universiteti duhet të përgatis të rinjtë për një shoqëri virtuale, në të cilën mijëra profesione që ushtrohen sot, brenda pak vjetëve nuk do të ekzistojnë si të tilla dhe do të zëvendësohen nga puna virtuale. Universiteti duhet të përgatis të rinjtë për tregun global të punës, sepse ky treg tashmë pothuajse është globalizuar.

Në këtë proces të transformimeve rrënjësore të shoqërisë dhe të teknologjisë informative, Universiteti është ndërlidhja më e mirë e tregut të dijes dhe tregut të punës të Kosovës me atë ndërkombëtar.

Universiteti duhet të shikojë kah mundësitë e reja për zhvillim. Janë dy mundësi të mëdha, të cilat duhet të hulumtohen dhe të zhvillohen:

1. Universiteti të orientohet kah projektet ndërkombëtare dhe hulumtimi në përmasa ndërkombëtare. Ka shumë fonde publike ndërkombëtare, sidomos ato të Komisionit Europian, të cilat presin hulumtuesit e rinj nga mbarë bota. UKZ duhet të përgatis stafin e vet akademik të arrijë këto fonde. Duke marrë nga këto fonde, për shkak të infrastrukturës ligjore të favorshme të BE, Universiteti dhe hulumtuesit e tij do të kycen deri në fund në rrjedhat e hulumtimit shkencor global.
2. Të kërkohet që financimi i universiteteve publike në Kosovë të bëhet në dy vija të ndryshme: vija e parë të jetë lineare për të gjitha universitetet (paga dhe mëditje dhe investimet kapitale), ndërsa vija e dytë të mos jetë lineare, por të shpërndahet në bazë të konkurrencës dhe performancës së secilit universitet. Kjo do të fuste në konkurrencë edhe universitetet publike midis tyre dhe do t'i shtynte përpara projektet hulumtuese kombëtare.

Në këtë rrugë ka shumë vështirësi.

Në një shoqëri e cila është në proces të stabilizimit të shtetit, të ekonomisë, të demokracisë dhe të të gjitha shtyllave shtetërore e sociale, çfarë është shoqëria kosovare sot, hartimi i strategjive zhvillimore aq sa është i domosdoshëm është edhe i vështirë. Vështirësia e parë është harmonizimi i prioriteteve strategjike dhe i veprimeve për të arritur ato prioritete me strategjitë e tjera kombëtare, siç janë: *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021; Plani Strategjik i*

Arsimit në Kosovë 2017-2021 dhe sidomos Korniza Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019 dhe Korniza Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021. Për UKZ kjo është vështirësi edhe më e madhe, sepse duke qenë universiteti i ri e në konsolidim e sipër, ka gjithnjë vështirësi në krijimin e resurseve njerëzore dhe të atyre financiare. Kështu, interesat strategjike të Universitetit viktimizohen për shkak të shkallëve të tjera zhvillimore në sektorë të tjerë të Qeverisë dhe për shkak të interesave në fusha dhe në institucione të tjera të Qeverisë. Kështu, për shembull, mbipunësimi në administratën publike në Kosovë apo pamjaftueshmëria e buxhetit të Qeverisë, e dëmtojnë shumë sidomos Universitetin “Kadri Zeka”, i cili duke qenë universiteti në ngritje e sipër, ka nevojë emergjente të ketë staf më të madh akademik, numër më të madh të administratës apo programe të reja studimore, e me këtë edhe më shumë financa.

Vështirësia e dytë është zbatimi në praktikë i asaj që është qartësuar e harmonizuar në këtë strategji. Edhe nëse ka një harmonizim midis prioriteteve strategjike të UKZ-së dhe dokumenteve të tjera strategjike nacionale, UKZ në këtë fazë të zhvillimit është tërësisht i varur financiarisht prej buxhetit të Qeverisë dhe këto prioritete viktimizohen shpesh, për shkak të mungesës së financave apo të ndonjë vendimi tjetër administrativ (p.sh., Letërqarkorja e ministrit të Financave, e datës 8.2.2017, që asnjë vend i ri i punës, i rregullt apo i angazhuar, në staf akademik apo në administratë, nuk mund të hapet pa një leje të veçantë të Ministrisë së Financave për disponueshmërinë e mjeteve financiare).

Një vështirësi tjetër është të kuptuarit e shoqërisë për rolin e universitetit. Jo rrallë shoqëria jonë i kupton studimet universitare si një obligim e jo si një përkushtim për profesionalizim dhe për punë shkencore. Kjo mënyrë e të kuptuarit krijon një proporcion të zhdrejtë: e shton ndjeshëm pritshmërinë e studentëve dhe zvogëlon angazhimet e tyre. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e studimeve.

Një vështirësi tjetër është fryma a pamjaftueshme akademike si brenda Universitetit ashtu edhe në bashkësi. Ende në shoqërinë tonë nuk ekziston një perceptim i drejtë për rolin e rëndësishëm të vlersimit të dijeve dhe matjes së dijeve me nota. Ende diploma universitare konsiderohet si një dokument sa për t’u punësuar diku. Njësoj është edhe me frymën akademike të studentët: duke qenë se ata nuk kanë një kampus të mirë e të plotësuar universitar, nuk kanë konvikte ku flejnë, ata bartin në universitet mendësinë e ngushtë të rrethit ku jetojnë, kryesisht rural, e cila mendësi në të shumtën e rasteve nuk përkon me mendësinë universitare.

Pavarësisht nga vështirësitë, kjo Strategji do të jetë një ndihmë e madhe për UKZ-në në rrugën përpara. Studentët, shoqëria, familjarët, menaxhmenti, qeveria dhe të gjithë hisedarët e tjerë me të drejtë presin rezultate nga universiteti dhe për këto rezultate të gjithë duhet të japin kontributin e tyre.

Na priftë e mbara të gjithëve!

Gjilan

Prill 2017 (rishikuar 2020)

PROCESI I HARTIMIT, RISHIKIMIT, METODOLOGJIA

4. Procesi i Hartimit të Strategjisë Zhvillimore 2017-2022 në vitin 2017

Hartimi i Strategjisë Zhvillimore të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan për periudhën 2017-2022 është inicuar në mbledhjen XI të Këshillit Drejtues të UKZ-së, më 30 shtator 2016.

Fillimisht lidhur me hartimin e këtij plani u shtruan katër çështje si në vijim:

- Kush jemi ne si institucion?
- Ku duam të shkojmë?
- Si mund të arrijmë atje?
- Si do ta tregojmë nëse kemi arritur?

Përgjigjet e këtyre katër pyetjeve përcaktojnë rrugën drejt objektivit të këtij plani: të përparojmë UKZ-në si një entitet i vetëm, i cili tërheq personelin akademik më të mirë dhe më të zgjuar dhe studentët të cilët janë të motivuar nga një angazhim për të dhënë kontribute transformuese në Kosovë, rajon e më gjerë. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të UKZ-së do të udhëhiqen nga ky SStrategjisë Zhvillimore, i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të UKZ-së mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e vet të IX, mbajtur më 10.06.2016 ka marrë vendim për hartimin e Strategjisë Zhvillimore të Universitetit "Kadri Zeka" dhe ka emëruar Grupin Punues, të ngushtë, të përbërë prej 3 anëtarësh: Akademik Fejzulla Krasniqi, kryesues, Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi dhe Prof. ass. dr. Arben Dermaku për të hartuar konceptim dhe agjendën e hartimit të strategjisë. Gjithashtu, KD ka emëruar Grupin punues, të gjerë, të përbërë nga të gjithë anëtarët e KD-së, prorektorët, dekanët e njësive akademike, studentët dhe administrata.

Grupi punues, ka kompletuar me kohë portfolion e gjithë dokumentacionit relevant për hartimin e dokumentit të Strategjisë Zhvillimore me fokus në dokumentet strategjike të MASHT-it për arsimin e lartë, dokumentet strategjike të UKZ-së për sigurim të cilësisë dhe hulumtime, si dhe dokumentet e tjera relevante të universiteteve evropiane dhe amerikane.

Përgatitja e dokumentit ka ndjekur dinamikën e aprovuar nga Këshilli Drejtues që ka përfshirë fazat: draftimin e dokumentit nga grupet punuese; finalizimi i dokumentit për diskutim, diskutimi me njësitë akademike, studentët, donatorët dhe partnerët, para se të aprovohet nga Këshilli Drejtues.

Grupi punues i ngushtë ka mbajtur takime pune dhe konsultative më 18-20 nëntor 2016, më ç'rast ka përcaktuar shtyllat kryesore dhe ka punuar një draft inicial, i cili u është dërguar për kontribute njësive akademike që funksionojnë në kuadër të UKZ-së. Të gjitha fakultetet kanë organizuar punëtori, në periudhën 10 dhjetor 2016 deri 28 dhejtor 2016, me këshillet e fakulteteve dhe kanë paraqitur prioritetet dhe planet zhvillimore të tyre bazuar në kornizën e Grupit punues.

Grupet punuese, bashkërisht, më 24, 25 dhe 26 shkurt 2017 kanë mbajtur një punëtori, e cila është karakterizuar me debate, analiza dhe perspektiva të ndryshme, ku në detaje janë reflektuar prioritetet dhe nevojat, masat dhe vështirësitë për Strategjinë Zhvillimore të UKZ-së 2017-2022.

Në këtë punëtori, Këshilli Drejtues ka emëruar një komision prej tre anëtarësh për ta finalizuar dhe redaktuar Strategjinë Zhvillimore, bazuar në dokumentet e grupeve punuese dhe raporteve të njësive akademike.

Në mbledhjen e XV të Këshillit Drejtues, më 2.5.2017, Këshilli Drejtues ka miratuar Strategjinë Zhvillimore të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

Këshilli Drejtues dhe rektori falënderon të gjithë ata që kontribuuan në çfarëdo mënyre në hartimin e Strategjisë zhvillimore të UKZ-së për periudhën 2017-2022.

5. Procesi i Rishikimit në vitin 2020

Duke parë dinamikën e madhe të zhvillimit të UKZ-së, menaxhmenti i universitetit ka hapur gjatë vitit 2020 procesin e diskutimit dhe të rishikimit të Strategjisë Zhvillimore dhe Planit të Veprimit 2017-2022.

Ky diskutim ka rezultuar me nevojën e fillimit edhe të procedurave formale të rishikimit të kësaj strategjie. Kjo dinamikë e shtuar nënkupton rritjen e programeve studimore, krijimin e nivelit të dytë të studimeve Master si dhe fillimin e bashkëpunimit për krijimin e programeve të doktoraturës, krijimin e Fakultetit të ri, rritjen e numrit të stafit akademik, rritjen e hulumtimeve shkencore, rritjen e numrit të stafit administrativ, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, rritjes së numrit të projekteve ndërkombëtare, rritjes së anëtarësimeve ndërkombëtare, etj. shumica e objektivave specifike të parapara në Planin Strategjik 2017-2022 janë realizuar ose janë në proces të realizimit në vitin 2020, prandaj u shtrua nevoja imediate për procesin e rishikimit, i cili nënkupton një ndryshim të vogël në përcaktimin e objektivave specifike në të cilat do të punohet deri në procesin e hartimit të Planit të ri Strategjik në vitin 2022.

Procesi i Rishikimit të Planit Strategjik është mbështetur nga projekti HERAS (Higher Education, Research and Applied Science) 2020-2023 që është duke u zbatuar nga WUS Austria (World University Service).

6. Metodologjia

Metodologjia e ndjekur gjatë procesit të rishikimit ka qenë si në vijim:

- Së pari është bërë analiza e palëve të interesit duke identifikuar aktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm (përfshirë Shoqërinë Civile, komunitetin e biznesit, institucionet tjera publike dhe jopublike, etj) që mund të japin kontribut në procesin e rishikimit.
- Mbi këtë bazë është formuar Komisioni i gjerë dhe Grupet Punuese për rishikim.
- Më pas janë analizuar dokumentet strategjike të arsimit të lartë në përgjithësi dhe atyre të UKZ-së në veçanti, përfshirë raportet e zbatimit të gjerëtanishëm të Planit Strategjik, pastaj dinamikat zhvillimore aktuale dhe atyre të synuara të UKZ-së, gjendja e strukturave dhe resurseve aktuale dhe projeksionet deri në vitin 2022, mbi bazën e të cilave pastaj është punuar në rishikimin e strukturës së dokumentit strategjik.
- Përmes punës interaktive në Grupe Punuese është ndërmarrë hapi tjetër që ka qenë një analizë SWOT, përmes së cilës janë identifikuar përparësitë, dobësitë (elemente të brendshme të UKZ-së) dhe mundësitë me rreziqe (elemente të jashtme të UKZ-së). Dhe

mbi këtë bazë pastaj janë identifikuar problemet dhe vështirësitë të cilat duhet adresuar deri në vitin 2022. Mbi këtë bazë është bërë analiza e problemeve në tërësinë tyre duke rezultuar me riformulimin dhe përshtatjen e Objektivave Strategjike dhe atyre Specifike me zhvillimet aktuale dhe atyre në ardhje. Ndërkohë që janë futur edhe Objektiva Specifike të reja, të cilat synohet të arrihen deri në vitin 2022 kur edhe përfundon afati i këtij Plani Strategjik.

- Hapi tjetër ka qenë përcaktimi i strukturave të monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Planit Strategjik dhe shpeshësinë e raportimeve. Edhe Plani i Veprimit për zbatimin e këtij Plani Strategjik është përshtatur në përputhje me strukturën e dokumentit të rishikuar.
- Me datën 26.11.2020 KD e UKZ-së ka mbajtur mbledhjen e XXI dhe ka marrur vendim për fillimin e procesit të rishikimit të strategjisë, i cili proces nuk do ta ndryshojë tërësisht, por do ta modifikojë PS me dinamikën e zhvillimit në UKZ. Po në të njëjtën mbledhje KD ka themeluar Komisionin në përbërje prej 35 anëtarëve, në të cilin janë përfaqësuar të gjithë aktorët kryesorë të UKZ-së, si dhe përfaqësuesit e hisedarëve të jashtëm të arsimit universitar.

Këshilli Drejtues ka caktuar një komision të ngushtë që do të udhëheq me këtë proces të rishikimit, i cili është përbërë prej:

1. MSc. Ibrahim Kosumi, kryesues i KD,
2. Prof. Asoc. Dr Bajram Kosumi, rektor i UKZ,
3. MSc. Yllka Behluli, anëtare e KD,
4. Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti, anëtar i KD
5. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, prorektor,
6. Prof. Ass. Dr. Bajram Fejzullahu, prorektor,
7. Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi, prorektor dhe
8. Mr. Vaxhit Sadriu, sekretar gjeneral.

- Për rishikimin fillestar të PSUKZ janë mbajtur dy punëtori, në nëntor dhe dhjetor 2020. Në këto dy punëtori Grupi Punues i ngushtë ka sugjeruar ndryshimet e bëra. Në këtë proces të rishikimit, KD ka vendosur që Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2017-2022 ta quajë “**Plan Strategjik të UKZ-së 2017–2022 (rishikuar në vitin 2020)**”.
- Më datën 14 dhe 15 dhjetor 2020 është organizuar punëtorja e tretë me hisedarët e brendshëm të Universitetit, ku janë ftuar të gjitha strukturat udhëheqëse dhe përfaqësuesit e të gjitha strukturave të UKZ. Aty janë diskutuar gjerësisht të gjitha ndryshimet e mundshme dhe, sidomos, janë diskutuar dhe vendosur objektiva shtesë specifike.
- Më datën 17 dhjetor është organizuar punëtorja e katërt për PS me hisedarët e jashtëm. Në punëtori janë ftuar anëtarë të Bordit Industrial Këshilldhënës të UKZ, biznesmenë dhe sipërmarrës të tjerë, kryetarë komunash, drejtorë të arsimit të komunave, përfaqësues të gjykatave, përfaqësues të OJQ si ata për persona me aftësi të kufizuara, të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të grave etj. Në këtë punëtori hisedarët e jashtëm kanë dhënë propozime interesante, disa prej të cilave janë inkorporuar në këtë Plan Strategjik, si:
 - ndërlidhja më e mirë e programeve studimore me bizneset dhe tregun e punës;
 - praktika të bëhet pjesë e kurrikulës (e detyrueshme) për të gjitha programet studimore;

- futjen e gjuhës së shenjave në Fakultetin e Edukimit, në mënyrë që të përgatiten edukatorët dhe mësuesit për komunikim në klasë edhe me nxënësit me nevoja të vecanta;
- krijimi i programeve studimore deficitare (programi studimor për fizikë, për gjuhë shqipe, për gjuhë angleze, për gjuhë gjermane, për dogana dhe shpedicion etj.)
- Mbas kësaj punëtorie, Grupi Punues e ka redaktuar tekstin e rishikuar të Planit Strategjik dhe e ka vënë në diskutim publik, më datë 19.12.2020. PS i UKZ është vendosur në ueb faqen e Universitetit, u është dërguar përmes emailit të gjitha anëtarëve të Grupit të Gjerë Punues, u është dërguar edhe hisedarëve të jashtëm, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit, Qeverinë e Kosovës, Komisionin Parlamentar për Arsim, Agjencinë së Kosovës për Akreditim, OJQ që mbikëqyrin procesin e arsimit të lartë, kryetarëve të komunave në Kosovën Lindore, drejtorëve të arsimit nëpër komuna etj. PS ka qëndruar në diskutim publik deri më dt. 27.12.2020.
- Mbas përfundimit të diskutimit publik, Grupi Punues ka organizuar edhe një punëtori në të cilën i ka harmonizuar të gjitha propozimet, komentet dhe reagimet nga procesi i diskutimit publik.
- Më datën 29.12.2020 Këshilli Drejtues i UKZ e ka miratuar Planin Strategjik 2017-2022 (rishikuar më 2020).

KAPITULLI I

KONTEKSTI I ARSIMIT TË LARTË

1. Sistemi arsimor në Republikën e Kosovës dhe Zona Evropiane e Arsimit të lartë: historia dhe gjendja aktuale

Historikisht, sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër faza shumë të rëndësishme dhe kritike, duke pasur parasysh rrethanat politike që janë krijuar ndër vite si pasojë e okupatorëve të ndryshëm në trojet tona. Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore shënon një etapë të pakthyeshme në sistemin arsimor të Kosovës, pasi lejohet hapja e shkollave në gjuhën shqipe, ku kulminacioni në këtë pikë arrihet në vitin 1969, me hapjen e Universitetit të Prishtinës (UP), i cili që nga kjo periudhë ka zhvilluar tri nivelet e studimeve në Kosovë, duke nxjerrur kuadro të reja. Pas heqjes së autonomisë së Kosovës në vitet 1989-1990, krijohet sistemi paralel arsimor në Kosovë, në të cilën fazë sistemi i arsimit shqip në Kosovë u shkëput tërësisht nga ai i Serbisë dhe i Jugosllavisë.

Pas përfundimit të luftës së vitit 1999, arsimi në Kosovë ka qenë subjekt i reformave në të gjitha nivelet: nga arsimi parashkollor deri në nivelin universitar. Këto reforma synojnë përshtatjen e arsimit në Kosovë, sipas standardeve bashkëkohore evropiane.

Prej vitit 2001, Kosova adapton në mënyrë unilaterale Procesin e Bolonjës, në kuadër të projektit të financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe implementuar nga Këshilli i Evropës. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë është gjithashtu koherent edhe me:

1. Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Higher Education Area EHEA - <http://www.ehea.info/>);
2. Hapësirën Evropiane të Kërkimeve Shkencore (https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/era_en);
3. Udhëzimet e Komisionit Evropian për Arsimin e Lartë; (Shih: https://enqa.eu/indirme/esg/ESG%20in%20Albanian_by%20KAA.pdf)
4. Deklaratën e Bolonjës; (Shih https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/1999_Bologna_Declaration_English_553028.pdf)
5. *Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE)* (Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, AESC);
6. *Konventën e Lisbonës* (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A12007L%2FTXT>).

Krahas kësaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrur *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*, në të cilin janë përcaktuar edhe kushtet e zhvillimit të Arsimit të Lartë në RKS. Ky Ligj ka krijuar Agjencionin për Akreditim në RKS, e cila ka vendosur Standardet për Akreditim të IAL-ve në Republikën e Kosovës, e të cilat janë në harmoni të plotë me dokumentet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Krahas këtyre zhvillimeve në arsimin e lartë në Kosovë, u ndie nevoja edhe për krijimin e Universiteteve të reja Publike. Nga viti 2010 deri në vitin 2015 u krijuan edhe 6 universitete të reja publike në Republikën e Kosovës. Në këto vite, respektivisht në vitin 2013 u krijua edhe Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe sistemi arsimor privat filloi të zhvillohet krahas atij publik, ku momentalisht operojnë me dhjetëra institucione private në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

2. Organizimi dhe struktura e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës

Sistemi i lartë arsimor në Republikën e Kosovës zhvillohet në nivelin baçelor, master dhe doktoratë. Në kuadër të arsimit të lartë, Sistemi i Bolonjës parashih ciklin e studimeve 3-vjeçare për të arritur titullin “baçelor”, ndërsa niveli i dytë i studimeve është master 2 vite, si dhe doktorata 3 vite.

Në Kosovë, aktualisht operojnë 9 institucione publike të arsimit të lartë dhe disa institucione private (<http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/download/higher-education-institutions>). Të gjitha institucionet arsimore në Republikën e Kosovës funksionojnë në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, qëllimi i të cilit është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane, si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

3. Sistemi i akreditimit në Republikën e Kosovës

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka krijuar Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, me qëllim të vlerësimit të cilësisë së duhur në arsimin e lartë të institucioneve publike dhe private. AKA është autoriteti i pavarur që bën akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë dhe programeve të studimit. Akreditimet bëhen në baza periodike në bazë të vlerësimit të pavarur nga rekomandimet e eksperteve të jashtëm. Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron shoqërinë se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Kriteret e akreditimit në kuadër të AKA janë dhënë në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011), si dhe në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 20/2016, datë 20.09.2016). AKA është e anëtarësuar me sukses si anëtare në këto institucione relevante ndërkombëtare: Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), Rrjeti i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë të Evropës Qendrore dhe Lindore në Arsimin e Lartë (EENQA), Rrjeti ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE), Regjistri i Sigurimit Cilësisë të Evropiane për Arsimin e Lartë (EQAR). Anëtarësimet në këto institucione padyshim se e vendosin AKA në nivelin e institucioneve më kredibile në rajon.

AKA në vitin 2018 ka krijuar Manualin për Akreditim të IAL-vë në Republikën e Kosovës, i cili ka avancuar dhe ka rritur kërkesat nga IAL-të për procesin e studimeve në IAL dhe cilësinë në këto institucione. Manuali i Akreditimit të AKA-së, bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimet Administrative nr. 9/2017 për

akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Kosovës dhe ligjin nr. 05 / L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

4. Historiku i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan u themelua me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 118/03 të datës 6 mars 2013, i cili nga Kuvendi i Kosovës u miratua më 30 maj 2013. Ky vendim i Kuvendit të Kosovës realizoi synimin dhe punën disa dekadëshe që është bërë në Gjilan me arsimin e lartë, prej vitit 1958 kur u themelua Qendra për Aftësimin e Mësimdhënësve (shkollë për përgatitjen e mësuesve). Në vitin 2002 Universiteti i Prishtinës e ka avancuar Shkollën e Lartë Pedagogjike në Fakultet të Edukimit. Në vitin 2010 Universiteti i Prishtinës ka themeluar në Gjilan edhe dy fakultete të tjera: Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik, si degë të veta. Në momentin e themelimit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan, të gjitha këto njësi akademike i janë bashkëngjitur universitetit të ri, duke krijuar kështu një lidhje historike të lindjes së këtij universiteti me Universitetin e Prishtinës.

Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen në shkollimin e lartë universitar të numrit më të madh të studentëve në Lindje të Kosovës, të Luginës së Preshevës, rajonit të Kumanovës nga Maqedonia Veriore si dhe të viseve të tjera nga Kosova. Në mbledhjen VIII të Këshillit Themelues të UKZ-së, mbajtur më 31.10.2013, u propozua që Universiteti Publik në Gjilan të ketë emrin “Kadri Zeka” dhe akronimin UKZ, propozim të cilin e ka miratuar MASHT-i më 13.11.2013.

Më 10.12. 2020 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Statutin e UKZ, me të cilin dokument, UKZ fiton pavarësinë administrative përfundimisht bëhet i pavarur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

UKZ ka themeluar nivelin e dytë të studimeve në vitin akademik 2017/2018, duke krijuar dy programe të veçanta/karakteristike në sistemin arsimor në RKS, duke krijuar një program interdisciplinar në mes tri fakulteteve në UKZ dhe tjetri duke krijuar një program për herë të parë në RKS si program të përbashkët mes tri universiteteve publike në RKS.

UKZ ka krijuar edhe dy fakultete të reja, ku njëri është akredituar në vitin 2019/2020 – Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe tjetri, i cili është në proces të akreditimit në vitin 2020/2021 – Fakulteti i Shkencave Sociale.

5. Organizimi dhe funksionimi i UKZ-së

Funksionimi i UKZ-së bëhet konform Statutit të UKZ, i cili është miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Republikës së Kosovës. Në UKZ mësimi organizohet në 5 njësi akademike (fakultete), të cilat ofrojnë programe studimore:

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Bachelor i edukimit parashkollor
		Fillor	BA	Bachelor i edukimit fillor

2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
3.	Fakulteti Ekonomik	Banka financa dhe kontabilitet	BSc	Bachelor i bankave financave dhe kontabilitetit
		Menaxhment	BSc	Bachelor i menaxhmentit
		Marketing	BSc	Bachelor i makertingut
4.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat kompjuterike	BA	Bachelor i shkencave kompjuterike
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Bachelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Sh. Kompjuterike Fakulteti Juridik Fakulteti Ekonomik	E- Qeverisja	MA	Master i E- qeverisjes
7.	Universiteti i Gjilanit Universiteti i Prizrenit Universiteti i Pejës	Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike	MA	Master i Qeverisjes Lokale dhe Shoqërisë Demokratike

Tabela nr. 1: Numri i fakulteteve, i programeve studimore dhe titulli që fitohet (UKZ)

Numri i studentëve të pranuar në UKZ gjatë viteve është i madh. Sidomos ka pasur një fluks të pa planifikuar në fillim. Në vitet e mëpastajme UKZ ka miratuar politika të zvogëlimit të kuotave në disa fakultete.

Viti akademik Fakulteti	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21	Totali
Edukim	401	210	277	221	202	196	167	199	1873
Juridik	454	372	296	272	257	226	203	178	2258
Ekonomik	608	608	497	386	245	244	234	235	3057
Shkenca Kompjuterike		96	91	115	96	73	63	76	610
Shkenca Aplikative; Matematikë Arsimore							22	33	55
Shkenca Kompjuterike, Ekonomik &					60	44	37	46	187

Juridik; E-Qeverisja									
Juridik; QLSHD					50	28	22	34	134
Gjithsej	1463	1286	1161	994	910	811	748	801	8174

Tabela nr. 2: Numri total i studentëve të regjistruar në UKZ nga viti 2013 deri në vitin 2020 (UKZ)

Nga shifrat e mësipërme shihet një rënie e lehtë latente e studentëve të regjistruar. Kjo nuk shpjgohet vetëm me proceset globale të migrimeve, por edhe me politikat e UKZ për zvogëlimin e kuotave të studentëve të pranuar në disa fakultete, si në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik, për shkak të stërmbushjes së tregut të punës me juristë dhe ekonomistë të diplomuar. Përndryshe, konkurrenca për një vend të studentit në UKZ është e madhe: në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin e Edukimit, në programet master, në Fakultetin e Shkencave Aplikative konkurrenca shkon 3-4:1, pra ka tre deri në katër kandidat për një vend të studentit. Në disa programe të tjera studimore, si në Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik konkurrenca është më e vogël.

Interesimi më i madh i studentëve të rinj paraqitet për programet e edukimit fillor, shkencave kompjuterike, matematikën arsimore, për juridik dhe ekonomik. Po ashtu interesim i jashtëzakonshëm i studentëve gjatë vitit të kaluar ishte për programet master E-qeverisja dhe Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike dhe E-Qeverisja.

UKZ në vitin 2017 ka pasur 26 profesorë me orar të plotë, prej këtyre dy janë me thirrje profesorë të asocuar dhe 24 profesorë asistentë. Gjithashtu, në UKZ janë tre ligjërues dhe 11 asistentë me orar të plotë. Në anën, tjetër numri i studenteve ka qenë 4904. UKZ është detyruar të angazhojë staf akademik të jashtëm (pas time) për të mbuluar zbrazëtinë e proporcioni staf akademik-student. Sa do është mbuluar, kjo marrëdhënie nuk ka qenë e kënaqshme.

Ndërsa nga viti 2017 e deri më sot, në vitin 2020 ka një përmirësim të dukshëm: UKZ ka 51 staf akademik me orar të plotë dhe 50 staf akademik *part time*. Përveç në lëndë të arteve dhe asistentët për ushtrime, i gjithë stafi akademik është me titullin doktor shkence, ndërsa shumica prej tyre kanë thirrje akademike. Është shtuar numri i profesorëve të pranuar me kontratë të plotë, asistentët e UKZ kanë doktoruar dhe janë zgjedhur profesorë dhe tash marrëdhënia staf akademik-student është shumë më i kënaqshëm se në vitin 2017.

Një interesim të vecantë UKZ i ka kushtuar edhe marrëdhënies numerike profesor-student. Kështu që tashmë kemi një marrëdhënie relativisht të mirë, të afërt me mesataren europiane: 1 staf akademik me 22 studentë (1:22). Shih këtë marrëdhënie në vitin 2020:

Në tabelën vijuese është paraqitë ky raport në nivel institucioni dhe të njëjstive akademike (fakulteteve).

FAKULTETI	Programi i Studimit	Gjinia		Gjithsej Studentë	Staf akad. i rregullt	Staf akad. i angazhuar	Raporti St. Akad.-Student
		Femra	Meshkuj				
		Fakulteti i Edukimit					
	Fillor	405	44	449			
	Parashkollor	291	4	295			
Fakulteti Juridik	Juridik i pwr gjithshwm	383	191	574	10	18	
Fakulteti Ekonomik				574	15	4	
	Banka,Financa, dhe Kontabilitet	151	158	309			
	Menaxhment	77	46	123			
	Menaxhim dhe Ndërmarrësi	41	44	85			
	Menaxhment dhe Informatike	19	14	33			
	Marketing	18	6	24			
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat Kompjuterike	69	152	221	9	7	
Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematika Arsimore	32	19	51	8	4	
F. Ekonom. F. Jurid. FSHK	E-Qeverisja (master)	66	56	122		1	
UKZ Gjilan UHZ Pejw UUH Prizr.	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (master)	27	30	57		6	
Gjithsejtë		1579	764	2343	45	57	1:52 1:22,9

Tabela nr. 3: Numrin e stafit akademik në raport me studentët në vitin 2020. (UKZ)

6. Gjendja e arsimit në UKZ

UKZ në vazhdimësi dhe prej se është themeluar ka qenë e përkushtuar për të forcuar cilësinë dhe rëndësinë e programeve studimore si dhe lidhjen e tyre me tregun e punës si parakusht për punësim, zhvillim ekonomik dhe rritje të mirëqenies sociale. Zhvillimi i një shoqërie moderne dhe ekonomisë së saj varet në një masë të madhe nga aftësia për të prodhuar dhe përvetësuar aftësi dhe njohuri të reja. Kjo sfidë është veçanërisht e theksuar në Kosovë, kur u botuan testet PISA-s të drejtuara nga OECD në dhjetor 2016, teste këto që shpërfaqën vështirësitë dhe sfidat e sistemit arsimor në Kosovë, duke ngjallur kështu një reflektim publik multidimensional për të vendosur në rend të parë përmirësimin e cilësisë së arsimit në tërësinë e tij.

Edhe UKZ është duke bërë përpjekje maksimale për të qenë në linjë me prioritetin kryesor të Kosovës e që është zhvillimi ekonomik përmes masave dhe sektorëve që kërkojnë shumë më

shumë dinamizëm dhe rezultate afatshkurtra dhe afatmesme, duke u mbështetur në avansimin e programeve ekzistuese, hapjen e programeve të reja dhe nxitjen e inovacioneve. Sidoqoftë, UKZ - ashtu sikurse të gjitha universitetet në Kosovë - përballet me një numër sfidash në arritjen e këtij objekti. Reformat në arsim të lartë në vitet e kaluara kanë përmirësuar klimën e biznesit si dhe kanë kontribuar në një masë në rritje ekonomike, por sfidat përfshijnë papunësinë e vazhdueshme (në veçanti midis të rinjve), zhvillimi i kufizuar i konkurrencës dhe produktivitetit në sektorin privat.

Problemi i ndërlidhjes së arsimit me nevojat e tregut, më konkretisht me punësimin e fuqisë punëtore ka të bëjë me çështje të cilësisë, me pamjaftueshmërinë e ndërlidhjes midis kualifikimeve të marra dhe atyre të nevojshme për të kontribuar në zhvillimin e sektorit privat. Universitetet publike në Kosovë, përfshirë UKZ-në, kanë kaluar nëpër shumë sfida në rrugët e tyre të zhvillimit që nga themelimi i tyre. Këto sfida duket se janë zhvillimi i tyre strategjik, qëndrueshmëria financiare dhe institucionale si dhe krijimi i identitetit të tyre dhe pse jo të profilit në peisazhin e arsimit të lartë, si dhe në rajonet ku veprojnë. Me gjithë zhvillimet dhe arritjet e gjertanishme sektori i arsimit të lartë përballet me vështirësi të cilat ky Plan Strategjik do t'i adresojë duke u dhënë orientim zhvillimor pikërisht atyre fushave ku ka nevojë më së shumti për ndërhyrje.

Prandaj, vetë Objektivat Strategjike dhe Specifike të hartuara dhe renditura në këtë Plan Strategjik japin orientimet e nevojshme se në cilat fusha duhet orientuar arsimit në UKZ duke radhitur, ndër të tjera, nevojën për të investuar në ngritjen e kapaciteteve akademike e administrative, pastaj duke përmirësuar edhe më tej infrastrukturën e përgjithshme për mësimdhënie, mësimnxënie, kërkime shkencore e publikime, rritjen e përpjekjeve për profilizimin të universitetit në shërbim të ndërlidhjes sa më të mirë të arsimit të lartë me nevojat e tregut të punës duke pasur parasysh dinamikat e shpejta globale që po ndryshojnë shumë më shpejtë se sa që ka mundur të paramendohet ndonjëherë, sigurimin e pavarësisë financiare të UKZ-së dhe rritjen e llogaridhënies, zgjerimin e partneriteteve brenda dhe jashtë Kosovës si dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha dimensionet e mundshme.

KAPITULLI III

SWOT ANALIZA

Përparësitë	Dobësitë
Të qenët universitet i ri: përvoja bashkëkohore dhe orientimi drejt një shoqërie moderne	Vështirësi në të kuptuarit e misionit nga disa hisedarë të jashtëm.
Aplikimi dhe adaptimi i shpejtë i reformave si universitet i ri dhe në zhvillim	Hapësirat e pamjaftueshme, sidomos laboratorët, ndikojnë në realizimin e vështirë të hulumtimeve
Stabiliteti financiar – financimi nga Qeveria	Në çështje të funksionimit të institucionit pamundësia e të vepruarit në mënyrë të shpejtë dhe fleksibile për shkak të procedurave të tejzgjatura burokratike.
UKZ është themeluar në një qendër si Gjilan, rreth të cilit gravitojnë një numër i konsiderueshëm i qyteteve të Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë Veriore.;	Mungesa e hapësirës
Në UKZ studiojnë studentë nga të gjitha anët e Kosovës dhe jashtë Kosovës;	Vetëdijësimi i studentëve për rëndësinë e vlerësimit të njohurive
Programet studimore të orientuara kah tregu i punës;	Tregu i pamjaftueshëm i punës
Kultivimi i frymës akademike brenda universitetit.	Trajnimi i pamjaftueshëm i stafit akademik dhe administrativ
Programet studimore në trend me botën virtuale (shkencat kompjuterike, matematika arsimore, E-qeverisja, edukimi, qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike etj.)	Vështirësitë në zotërimin e gjuhëve të huaja nga stafi
Bashkëpunimi me komunitetin, biznesin dhe industrinë;	
Imazhi pozitiv i Universitetit në komunitet;	
Orientimi i UKZ kah shoqëria moderne, multikulturore dhe kah tregu global i punës;	
Bashkëpunimi ndërkombëtar në projekte të Erasmusit dhe në projekte të tjera.	
Cilësia e lartë e studimeve të ofruara	

Studentët e diplomuar gjinden suksesshëm në tregun e punës; vendor dhe ndërkombëtar	
Aplikimi i shpejtë i mësimit online nga stafi dhe studentët	
Aftësi adaptimi në kushte të reja teknologjike dhe elektronike	
Bashkëpunimi ndërkombëtar –	
Projektet kombëtare dhe ndërkombëtare të fituara	
Mundësitë	Rreziqet
Përshtatja me ndryshimet e tregut global	Infrastruktura jokonsistente ligjore për Arsimin e Lartë
Përshtatja me botën virtuale dhe teknologjinë e re	Reformat e shpeshta nga Ministria e Arsimit pa përfunduar reforma paraprake
Implementimi i plotë i Sistemit të Bolonjës	Rreziku i të kuptuarit të UKZ nga komuniteti si “universitet lokal”, përkundër faktit se universiteti është universal;
Rritja e numrit të rekrutimeve të reja të stafit akademik dhe administrativ	Ligji për Arsimin e Lartë është i tejkaluar nga zhvillimet në arsimin e lartë.
Stafi akademik i moshës së re me kompetenca për teknologjinë informative dhe prirjet virtuale të shoqërisë bashkëkohore;	Të keqkuptuarit e procesit të “profilizimit të universiteteve”, duke i detyruar universitetet e reja të fokusohen vetëm në disa fusha të ngushta studimore;
Thellimi i bashkëpunimit me bizneset dhe industrinë në të akceptuar të misionit të Universitetit (Shih: Plani Strategjik)	Politizimi i politikave arsimore nga struktura dhe nivele të ndryshme qeverisëse (si psh. ndërhyrjet politike në Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe përjashtimi i tij nga EQUAR dhe ENQA).
Adaptimi i arritjeve të fundit teknologjike-shkencore në punën kërkimore dhe mësimore në UKZ.	Moskuptimi i duhur nga ana e studentëve i rëndësisë së vlerësimit të njohurive.
Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes projekteve të Erasmusit dhe të fondeve të tjera publike e bëjnë më të realizueshëm misionin (Shih: Plani Strategjik)	
Rritja e mundësive të UKZ për lidhjen e mësimit akademik me praktikën dhe e interesimit të studentëve për mësimin praktik (Shih: Plani Strategjik)	

KAPITULLI IV

VIZIONI, MISIONI, VLERAT

1. Vizioni

Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

Ky është vizioni ynë.

Universiteti ynë është mundësia më e mirë për krijimin dhe avansimin e vlerave themelore njerëzore, për secilwn kohë dhe në çdo hapësirë.

Vetëm duke krijuar vlera të larta shkencore, kulturore, ekonomike e sociale ne e ndihmojmë shoqërinë tonë në ballafaqim me shekullin e teknologjisë informative dhe të globalizmit.

Universiteti është urë lidhëse midis vlerave lokale, vlerave nacionale dhe vlerave globale. Ai është dera më e mirë e Kosovës për në epokën e teknologjisë dixhitale, në të cilën mbarë njerëzimi po jeton si një shoqëri multikulturore. Edhe në kontekstin kosovar, edhe në atë shqiptar, Universiteti është vendi ku bashkohen kultura të ndryshme, gjuhë të ndryshme, raca të ndryshme, individë me besime fetare të ndryshme dhe individë me status social të ndryshëm. Universiteti, duke i qëndruar besnik vetë thelbit të fjalës universal, do të nxisë dhe respektojë multikulturalizmin dhe diversitetin.

Jeta e ardhme e shoqërisë sonë, dija, shkenca dhe edukimi, familja, ekonomia e ardhme, mirëqenia, demokracia dhe pozita në arenën ndërkombëtare varen nga mënyra se si rrjedhin sot proceset në universitete.

Universiteti do të edukojë dhe mësojë studentët e sotëm me përgjegjësitë publike të ardhme.

Universiteti e edukon shoqërinë për një jetë në paqe dhe në mirëqenie.

Universiteti përgatitë lidërshpin e shoqërisë sonë të ardhme.

2. Misioni

Misioni i UKZ është:

Tempull i dijes i cili kultivon nxënien dhe zhvillimin e dijeve, nxit mendimin kritik dhe shpirtin e ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik, përgatit të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie virtuale dhe globale, pjesë e një tregu të hapur të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Ky mision është i mbështetur në disa shtylla: mësimi dhe dija; shoqëria moderne dhe konkurrenca lojale; tregjet moderne të punës; mendimi kritik, hulumtues dhe ndërmarrës.

Ky mision është koherent me misionin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, përkatësisht me *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*, me *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021* (shih: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf) dhe me *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021* (SKZH) (shih: http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf).

Po ashtu, misioni publik i UKZ është koherent edhe me:

1. Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Higher Education Area EHEA - <http://ëëë.ehea.info/>);
2. Hapësirën/ Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore;
3. Udhëzimet e Komisionit Evropian për Arsimin e Lartë; (Shih: https://enqa.eu/indirme/esg/ESG%20in%20Albanian_by%20KAA.pdf)
4. Deklaratën e Bolonjës; (Shih https://ëëë.uni-gjilan.net/ëp-content/uploads/2020/12/1999_Bologna_Declaration_English_553028.pdf)
5. *Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE)* (Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, AESC);
6. *Konventën e Lisbonës* (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A12007L%2FTXT>).
7. Plani Kombëtar për zbatimin e MSA 2020-2024, Neni 107 (http://mei-ks.net/repository/docs/1_pkzmsa_miratur nga_kuvendi_final_.pdf)

3. Vlerat themelore

Vlerat themelore mbi të cilat ne realizojmë misionin dhe vizionin tonë janë:

- a. Barazia: në kushtet për fitimin dhe gjenerimin e dijes, e cila reflektohet në mosdiskriminimin e askujt;
- b. Kreativiteti: i reflektuar në hapjen tonë ndaj ideve të reja dhe format e shprehjes, kureshtje intelektuale, mendim kritik, gatishmëri për t'u ballafaquar me rreziqe dhe frymën sipërmarrëse;
- c. Integriteti: i reflektuar në aderimin tonë me standardet më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale, si dhe në angazhimin tonë për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në çdo gjë që bëjmë;
- d. Qëndrueshmëria: e reflektuar në angazhimin tonë të përbashkët për të udhëhequr me shembull në ruajtjen dhe mbrojtjen e interesit publik dhe në qasjen tonë ndaj planifikimit përgjegjës financiar;
- e. Ekselencia: Kërkojmë përsosmëri. E kuptojmë modelin e të mësuarit kritik dhe përmes praktikës, disiplinën dhe përgjegjësinë, kontrollin dhe matjen e cilësisë dhe presim standardet e larta për veten dhe të studentëve tanë;
- f. Lidhja: Jemi një ekip i integruar. Funksojmë rreth parimit të besimit, bashkëpunimit dhe lidhjes në disiplina tona të ndryshme dhe në të gjithë botën;
- g. Fryma akademike: kultivojmë frymën akademike në jetën tonë universitare, diskutojmë për problemet lokale dhe globale dhe mundohemi të anticipojmë rrugën e gjat të shoqërisë sonë.

KAPITULLI V

QEVERISJA DHE ORGANIZIMI

1. Këshilli i Drejtues (KD) i Universitetit është organi kryesor qeverisës i Universitetit. KD është përgjegjës për të gjitha çështjet e politikave afatgjata dhe për politikat financiare dhe e zgjedh rektorin e Universitetit. Ai është trupi më i lartë llogari-marrës në UKZ. KD përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve: 4 prej tyre zgjidhen në cdo tre vjet në procesin e rregullt zgjedhor në Universitet, ndërsa tre prej tyre i emëron ministri i MASH, me vendim të vecantë. KD kryesohet, kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi, të zgjedhur nga KD, nga anëtarët e emëruar nga MASH.

2. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues dhe akademik i Universitetit. Rektori i raporton KD.

Rektorin e zgjedh KD për një mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhje dhe për një mandat tjetër, përmes një konkursi publik. Rektori është autoriteti që e përfaqson Universitetin jashtë tij.

3. Senati është organi më i lartë akademik i Universitetit. Është organ vendim-marrës për të gjitha çështjet akademike.


Të gjitha organet qeverisëse të Universitetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash, nëse nuk përcaktohet ndryshe në Statut.

Organizimi i studimeve është në përgjegjësinë e fakulteteve. Fakulteti ka **Këshillin e Fakultetit**, i cili është organi më i lartë i tij për çështje akademike, ndërsa fakultetin e drejton **dekani**, i cili është autoriteti kryesor ekzekutiv i Fakultetit.

Administrata e Universitetit udhëhiqet nga **Sekretari i Përgjithshëm** i Universitetit.

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN

Struktura organizative



KAPITULLI VI

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

UKZ ka një vizion, një mision dhe një strategji të cilën do ta realizojë sipas këtyre objektivave strategjike, të cilat do të operacionalizohen në plane vjetore të veprimit.

1. UNIVERSITETI, SHOQËRIA DHE TREGU I PUNËS TË JETË NJË CIKËL DHE PROCES I NDËRLIDHUR

Objektivat specifike:

- 1.1. Programet studimore të jenë në përputhje me tregun e punës.** UKZ synon që programet e ofruara studimore të jenë në përputhje dhe harmoni me nevojat e tregut të punës, të shoqërisë dhe të vendit dhe të jenë kompatible me universitetet e tjera rajonale, evropiane dhe më gjerë, në mënyrë që studentet tanë të krijojnë aftësitë e kërkuara krijuese dhe ndërmarrëse. Të gjitha programet e reja që do të dërgohen për t'u akredituar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, do të kenë studimin e fizibilitetit dhe asnjë program i ri nuk do të propozohet po qe se nuk do të përputhet me nevojat e tregut të punës.
- 1.2. Hulumenti të ndërlidhet me zhvillimin e shoqërisë.** Gjithashtu, programet tona kanë për qëllim që të afirmojnë shkencën kosovare, në mënyrë që t'u përgjigjen sfidave ekonomike, juridike, politike dhe edukative të shoqërisë. Ne punojmë që studentët tanë të pajisen me njohuri të transferueshme dhe pas diplomimit të jenë konkurrentë në tregun vendor, rajonal dhe evropian të punës, duke përfshirë sektorin privat dhe publik.
- 1.3. Formimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Instituteve Hulumtuese.** UKZ do të themelojë institute hulumtuese për fushat e ndryshme studimore që janë me interes për UKZ-në, shoqërinë, ekonominë dhe për zhvillimin teknologjik.
- 1.4. Ofrimi i ekspertizave dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet dhe shoqërinë.** UKZ do të krijojë ekipe të ekspertëve të fushave të ndryshme, duke ofruar ekspertiza dhe shërbime të ndryshme për institucionet publike dhe private, duke ofruar shërbime për shoqërinë, për OJQ-të e ndryshme, etj.
- 1.5. Themelimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Zyrës për Karrierë.** Per t'iu përgjigjur këtyre sfidave, UKZ do të themelojë Zyrën e karrierës, qëllimi i së cilës do të jetë konsulenca e vazhdueshme e studentëve rreth tregut të punës, ndihma në përgatitjen e rezymeve dhe letrave të motivimit, si dhe informimi me kohë për pozitat e hapura në ndërmarrje të ndryshme tregtare në sektorin privat dhe në atë publik.
- 1.6. Themelimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit me Bordin Industrial Këshilldhënës.** Gjithashtu, UKZ synon të promovojë në mënyrë të vazhdueshme lidhjet akademike me industrinë dhe shoqërinë në mënyrë që të kontribuojë direkt dhe indirekt në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror. Kjo do të arrihet duke krijuar bordin këshilldhënës të bashkësisë që programet studimore të jenë konform kërkesave të punëdhënësve potencialë dhe si rezultat studentët e diplomuar ta kenë me lehtë që të futen në tregun e punës. Bordi do të luajë rol këshilldhënës edhe në numrin e studentëve të rinj që do të pranohen në të ardhmen.
- 1.7. Themelimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Zyrës për Alumni.** Për me shumë, UKZ do të themelojë shoqatën e të diplomuarëve të quajtur "Alumni". Në kuadër të kësaj,

do të krijohet një databazë me të dhënat e diplomuareve duke përfshi të dhënat kontaktuese, statusin nëse studentët janë të punësuar, pozitën që e mbajnë, rrogën që marrin. Në baza vjetore, UKZ në kampusin universitar do të organizojë takime të rregullta 6-mujore me të diplomuarit për të rritur bashkëpunimin në mesin e tyre.

2. AVANSIMI I PROGRAMEVE STUDIMORE NË TRI NIVELET E STUDIMEVE

UKZ synon që në një periudhe afatmesme të realizojë programe studimore në tri nivele të studimeve: baçelor, master dhe doktoratë.

2.1. Themelimi dhe zhvillimi i fakulteteve të reja: UKZ të themelojë një fakultet të ri në fushtë të Shkencave Aplikative dhe më këtë të hapë perspektivën e shkencave aplikative. Në të ardhmen të zhvillojë brenda këtij fakulteti edhe programet e mjekësisë aplikative. UKZ të thellohet dhe të zgjerohet më shumë studimet aplikative të shkencave ekzakte dhe kompjuterike.

Rëndësi të veçantë, UKZ do t'u kushtojë forcimit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, pasi kuadrot e tij janë të kërkuara në tregun e punës.

UKZ të themelojë edhe Fakultetin e Shkencave Sociale., duke ju përshtatur kërkesës së tregut të punës dhe zhvillimeve të nevojshme shoqërore.

2.2. Themelimi i programeve të reja studimore: UKZ do të themelojë edhe programe të reja studimore në varësi të kërkesave, nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të tjera në komunitet.

Në diskutimin me hisedarët e jashtëm (punëtorja e datës 18.12.2020), në përputhje me hulumtimin e tregut të punës, është kërkuar specifikisht që UKZ të zhvillojë edhe programe studimore në këto fusha:

- Fizikë
- Dogana dhe shpedicion
- Gjuhë anglese
- Gjuhë gjermane
- Programe studimore nga artet, sidomos në muzikë dhe arte figurative.

2.3. Themelimi i programeve master: Programet master janë në proces të vlerësimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe pritet që të akreditohen, ndërkaq studimet në këtë nivel të fillojnë në vitin akademik 2017/2018.

2.4. UKZ do të themelojë programe Master për secilën fushë të studimeve që e mbulon në nivelin e studimeve baçelor.

2.5. Themelimi i programeve të doktoraturës: Programi i doktoratës synohet të realizohet në vitin akademik 2021/2022 e tutje UKZ do të bashkëpunojë edhe më partnerë ndërkombëtarë dhe vendor në procesin e themelimit të studimeve të doktoraturës, madje duke përdorur edhe projektet Erasmus+ dhe Horizon 2020.

2.6. Programet multidiciplinare: UKZ synon të realizojë programe të reja studimore që do të kenë karakter multidisiplinar dhe do të krijohen në bashkëpunim me fakultetet brenda universiteteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

2.7. Programet e Përbashkëta: UKZ do të themelojë edhe programe tjera të përbashkëta në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare dhe vendore në të gjitha nivelet e studimit, Double Degree dhe Joint Degree

3. TË RRITET GJITHËPËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË AKTIVITETET UNIVERSITARE DHE KOMUNITARE

5.1. Bashkëjetesa e të ndryshmeve. UKZ nxit bashkëjetesën e të ndryshmeve në jetën studentore të UKZ. UKZ promovon mosdiskriminimin nacional, racor, gjinor, fetar, orientimin seksual, përkatësinë sociale apo rajonale etj. UKZ nxit fuqishëm multikulturalizmin, globalizmin dhe virtualizmin në jetën studentore.

5.2. UKZ vazhdimisht synon të tërheqë nxënësit e dalluar. Në programet studimore të ofruara UKZ synon të pranojë nxënësit e shkëlqyeshëm. Për këtë qëllim, përveq njoftimit të nxënësve të shkollave të mesme me mundësitë që ofron UKZ (si është Dita Informuese për Maturantët; <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/fillo-me-nje-enderr-perfundo-me-nje-te-ardhme/>), duhet të shtohet cilësia e provimit pranues që organizon UKZ.

Në veçanti, UKZ ka interes për studentët e trekëndëshit Kosovë – Maqedoni e Veriut-Serbi. UKZ ka për qëllim hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shkollat e mesme në rajonin Kosovë-Maqedoni e Veriut-Serbi, ku do të ketë mundësi që para afateve të provimeve pranuese të organizojë sesione informuese me nxënësit nëpër shkollat e mesme, në mënyrë që t'i informojë ata për mundësitë e studimit që ofron.

5.3. Mobiliteti i studentëve. UKZ të promovojë mobilitetin e studentëve me universitetet e tjera vendore, rajonale dhe ndërkombëtare që ka marrëdhënie bashkëpunimi dhe ofron lehtësira që ky proces të jetë sa më i përshtatshëm në shërbim të studentëve.

5.4. Qendra Multidisciplinare të udhëhequr nga studentët. UKZ të themelojë Qendrën Multidisciplinare, e cila ndërlidh kryerjen e punëve të ndryshme dhe shërbimeve për komunitetin.

5.5. Rritja e konkurrencës ndërmjet studentëve. Nxitja e garave të ndryshme studentore dhe shpërblimi i më të mirëve, si në gjuhë dhe letërsi, matematikë, oratori, degë sportive, në arte etj. UKZ të ndihmojë financiarisht themelimin e klubeve për këto gara, në modelin e Klubit të Oratorëve, tashmë të themeluar dhe të nxisë shpirtin e konkurrencës të studentët.

5.6. Fryma akademike të studentët. Nxitja e krijimit të frymës akademike dhe e kreativitetit në jetën e përditshme studentore.

5.7. Të ndërtohet një konvikt i ri i studentëve. Meqenëse studentët e UKZ jetëojnë në afërsi të kampusit, ata nuk janë sa duhet të lidhur me jetën studentore dhe me kampusin. Për këtë arsye në një të ardhme UKZ duhet që krahas kampusit të ri të themelojë një konvikt në të cilin do të jetonin studentët që jetojnë në largësi të caktuar. Kjo do ta ndihmonte organizimin e “jetës studentore”, njëkohësisht tejkalimin e mendësisë së ngushtë të familjes tradicionale.

5.8. Organizimi i studentëve në UKZ. UKZ nxit organizimin demokratik të studentëve në organizata studentore dhe në Parlamentin Studentor. Të krijohet një klimë sa më demokratike të studentët, në mënyrë që ata mos të përsërisin gabimet e “të vjetërve” në organizimet e tyre, mos të bien pre e partive politike apo e grupacioneve të interesit jo-

universitar, por organizatat e tyre të mbrojnë të drejtat dhe të promovojnë aktivitetet studentore.

5.9.Përkrahja financiare. UKZ të përkrahë financiarisht cdo aktivitet të planifikuar të studentëve i cili e nxit frymën demokratike, mendimin kritik, shpirtin e ndërmarrësisë dhe konkurrencën.

4. BURIMET NJERËZORE- ZHVILLIMI I MËTEJTMË I BURIMEVE NJERËZORE

4.1.Planifikimi efektiv. Planifikimi efektiv i stafit akademik dhe administrativ i UKZ-së është imperativ për funksionim sa me efikas dhe për t'iu përgjigjur kërkesave ligjore në fuqi. Ndonëse mund të ketë mangësi në këtë drejtim, UKZ vazhdimisht prinë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe gjithmonë është me kohë karshi procedurave ekzistuese që kërkohen.

4.2.Zhvillimi i mëtejme dhe profesional i Stafit akademik. Në kuadër të programeve ekzistuese studimore, UKZ përmbush kriteret ligjore me staf akademik. UKZ në vazhdimësi kërkon që të përmirësohet raporti staf-student, duke e sjellur këtë raport në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4.3.Zhvillimi i mëtejme dhe profesional i Stafit Administrativ. Stafit administrativ, UKZ duhet të rekrutojë vazhdimisht punëtorë të rinj me qëllim të kryerjes së punës me sa më shumë efikasitet, si dheme qëllim të pavarësimt nga MASHT.

4.4.UKZ duhet ta krijoj **nivelin e mesëm menaxherial** të administratës.

4.5.Mobiliteti i stafit administrativ. Mobiliteti i stafit administrativ konsiderohet shumë i rëndësishëm për të shkëmbyer dhe përfituar përvoja të reja, shkathtësi menaxheriale, dhe njohuri për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të universitetit.

4.6. Trajnimi. UKZ duhet t'i kushtojë kujdes më të madh trajnimit të stafit administrativ dhe të stafit akademik. Për stafin administrativ duhet krijuar një bashkëpunim më i madh me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe me institucione të tjera trajnuese.

4.7.Qendra e Përsosmërisë. Stafin akademik, sa do deri tash janë organizuar trajnime të jashtme dhe trajnimet e Qendrës së Përsosmërisë së Universitetit "Hasan Prishtinë" në Prishtinë, në të ardhme e mesme duhet të krijohet Qendra e Përsosmërisë e UKZ, e cila do të organizojë trajnimin e stafit akademik.

5. SISTEMI I SIGURIMIT TË CILËSISË- SIGURIMI DHE NGRITJA E CILËSISË

1.1.Hartimi i Strategjisë për sigurimin e cilësisë. UKZ do të hartojë strategjinë për sigurimin e cilësisë, e cila do të jetë në harmoni me sistemin e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë-

- 1.2. Të rishikohet Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në UKZ.** Rregullorja aktuale është e tejkualuar dhe disa aspekte të mbikëqyrjes e të matjes së cilësisë nuk i ka të rregulluara mirë. Ky ka qenë edhe vlerësimi i Ekipit të Ekspertëve në akreditimin institucional të vitit 2017. Prandaj kjo rregullore duhet të rishikohet.
- 1.3. Themelimi dhe zhvillimi i Zyrës për zhvillim akademik dhe cilësi.** UKZ do të themelojë Zyrën për cilësi që do të përbëhet nga stafi administrativ. Zyra për cilësi do të jetë e pavarur nga strukturat udhëheqëse të universitetit dhe roli kryesor i saj do të jetë monitorimi i cilësisë, i paanshëm dhe në përputhje me politikat zhvillimore të universitetit. Mostrat e vlerësimit dhe analizës së cilësisë, strategjia dhe modaliteti do të krijohet në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me AKA-në për të përmbushur dhe tejkualuar objektivat e përcaktuara.
- 1.4. Koordinatorët për Cilësi.** Të caktohen koordinatorët për cilësi dhe zhvillim akademik në secilën njësi akademike.
- 1.5. Këshilli për Mbikëqyrje të Cilësisë dhe për Vlerësim.** Të themelohet Këshilli për Mbikëqyrje të Cilësisë dhe për Vlerësim (Të shkruhen emrat korrekt). UKZ do të themelojë Këshillin për mbikëqyrje të cilësisë dhe vlerësim, i cili do të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë për vlerat e cilësisë.
- 1.6. Udhëzuesi i Planifikimit dhe Vlerësimit të performancës së stafit akademik.** UKZ të hartojë udhëzuesin (manualin) me të cilën do të udhëzojë si të matet cilësia në mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtime shkecore me parametra real duke hartuar edhe formular për këtë proces të matjes së cilësisë.
- 1.7. Të përmirësohet Rangimi ndërkombëtar i Universitetit “Kadri Zeka”.** UKZ do të përpilojë një raport të detajuar në lidhje me indikatorët e rangimit të universiteteve. Pastaj, do të bëjë një vlerësim të thuktë se ku qëndron në raport me parametrat e vlerësimit dhe si rrjedhojë, do të përpilojë strategjinë zhvillimore të saj që të dalim më të suksesshëm në rangimet vendore dhe ndërkombëtare.
- 1.8. Udhëzuesi për ECTS.** Të hartohet Udhëzuesi për ECTS dhe të vendoset në ueb faqen e UKZ.
- 1.9. Qasja në bibliotekat elektronike ndërkombëtare.** Të sigurohet qasja e UKZ-së në biblioteka elektronike ndërkombëtare.
- 1.10. Literatura bashkëkohore.** Të sigurohet literatura bashkëkohore për studentët. Në Syllabuset e kurseve, librat bazikë nuk duhet të jenë më të vjetër se 10 vjetë, përvec në raste të arsyeshme.
- 1.11. Përmbushja e standardeve.** UKZ të punojë jo vetëm të përmbushë të gjitha standardet e përcaktuara nga AKA, por edhe t'i tejkalojë ato, si është rasti edhe tash me fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

6. PËRMIRËSIMI DHE PROMOVIMI/PËRKRAHJA E PUNËS KËRKIMORE SHKENCORE

- 6.1. Të rritet kërkimi shkencor.** UKZ duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë punës kërkimore dhe shkencore dhe sidomos të orientuar në të mmirë të komunitetit. UKZ mbështesë botimin e veprave shkencore dhe të teksteve universitare, publikimin në

revistat shkencore dhe të nxisë punën kërkimore-shkencore të stafit akademik, duke ofruar mbështetje, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar.

6.2. Të miratohet Rregullorja për veprimtarinë kërkimore – shkencore. Me anë të kësaj Rregullore për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të UKZ-së, do të përkrahet stafi akademik në hulumtime shkencore dhe publikime shkencore.

6.3. Të formohet një Komision Qëndror që do të mbikqyrë punën kërkimore shkencore. Komisioni Qëndror planifikon, do të mbikqyrë, dhe do të përkrahë punën kërkimore shkencore në UKZ.

6.4. Të caktohen koordinatorët nëpër fakultete për punën kërkimore shkencore. Koordinatorët do të mbështesin stafin akademik në punën e tyre kërkimore shkencore, duke udhëzuar SA.

6.5. Mbështetja, Financimi dhe shpërblimi për punën kërkimore shkencore. UKZ mbështetë stafin akademik financiarisht për punën e tyre kërkimore shkencore: shpërblimi me një pagë për profesorin me më së shumti punime në UKZ dhe shpërblimi për shkencëtarin e vitit në UKZ.

6.6. Organizimi i konferencave shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Organizimi i tryezave dhe konferencave shkencore do të jetë prioritet i UKZ-së në mënyrë që temat me interes të debatohen dhe analizohen në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët e tjerë që kanë ndikim direkt dhe indirekt në tematikat e ngritura.

6.7. Krijimi i revistave të UKZ. UKZ, rëndësi të veçantë do t'i kushtojë paraqitjes së stafit akademik në revistat shkencore ndërkombëtare që të jenë në trend me zhvillimet dhe tematikat aktuale kudo në botë. Do të bëhen përpjekjet e duhura që të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për të mbështetur këtë objektiv dhe do të kërkohet përkrahje nga MASHT, universitetet me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi, si dhe me institucionet e tjera që përkrahin zhvillimin e shkencës.

6.8. Themelimi i Këshillit Botues. Këshilli Botues do të mbështesë botimin e teksteve universitare, monografive dhe botimeve të tjera.

7. PROFILIZIMI I UKZ-SË

7.1. UKZ ka për qëllim që krahas avancimit dhe reformimit të programeve aktuale në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik, të zhvillojë një proces të ngadaltë të profilizimit. Në këtë aspekt, synon të profilizohet kryesisht në edukim, shkenca kompjuterike, shkenca aplikative, shkenca sociale.

7.2. UKZ për të gjitha proceset e profilizimit të vetë duhet ta ketë vetë iniciativën.

7.3. UKZ e sheh procesin e profilizimit si proces akademik dhe vetërregullues e jo si një proces politik, centralist dhe mekanik, ashtu si është artikuluar në vitet e fundit në qarqe politik-bërëse, duke përfshirë edhe Ministrinë e Arsimit, në disa raste.

7.4. UKZ e sheh si rrezik orientimin e universitetit vetëm në pesë fakultete të veçanta dhe të ndryshme nga të tjerët, sepse kjo do të ishte një varfërim i universitetit. Universiteti do t'i orientojë programet studimore në bazë të kërkesave të tregut dhe potencialit të mbrendshëm të saj.

7.5. UKZ është autonome dhe fleksibile në hapjen e programeve të reja, të cilat e ndihmojnë profilizimin.

8. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

7.1. Duke qenë se buxheti i UKZ nga Qeveria e Kosovës nuk është i mjaftueshëm dhe duke pasur parasysh se vetëm përmes projekteve ndërkombëtare dhe mobilitetit akademik UKZ mund të kycet në proceset akademike ndërkombëtare, bashkëpunimi ndërkombëtar është jetik për zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të UKZ-së.

7.2. **Themelimi i Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar.** Me themelimin dhe funksionalizimin e Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar do të rritet vëllimi i punës, efikasiteti dhe mundësia. Mbështetja dhe zhvillimi i marrëdhënieve ndërkombëtare nga Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar do të jetë lehtësim për strukturën udhëheqëse të UKZ-së, stafin akademik dhe administrativ, si dhe studentët në veçanti.

7.3. **Hartimi i strategjisë dhe i planit të veprimit për bashkëpunim ndërkombëtar.** Hartimi i një plani të tillë duhet të ndodhë shpejt, sepse me të përcaktohen rrugët që UKZ-ja synon për realizimin gjatë këtyre viteve. Planit të veprimit është dokument që përcakton nevojat, mundësitë dhe kapacitetet të cilat i posedon UKZ-ja.

7.4. **Ndërkombëtarizimi i UKZ-së dhe anëtarësimi i UKZ-së dhe fakulteteve të tij në institucione e shoqata të ndryshme ndërkombëtare.** Universiteti do të shërbejë si urë lidhëse në mes të faktorëve shkencorë dhe biznesit për të rritur impaktin në rajon dhe Evropë. Përfshirja e UKZ-së në bashkëpunime rajonale dhe evropiane në vazhdimësi do të jetë domosdoshmëri dhe synim yni gjatë realizimit të kësaj strategjie.

Anëtarësimi i UKZ-së në rrjete të universiteteve dhe fakulteteve, si dhe programeve të tilla të ndryshme do të jetë prioritet. Kjo garanton një informim konstant të zhvillimeve të kësaj natyre në nivele të ndryshme. Informimi për zhvillime dhe qasja i ofron UKZ-së mundësinë për të qenë pjesë e trendeve ndërkombëtare, qoftë si bartës, universitet partner apo edhe pjesëmarrës.

Anëtarësimi i UKZ-së dhe fakulteteve të tij në institucione dhe shoqata të ndryshme ndërkombëtare, si dhe në Unionin e Rektorëve të Universiteteve Evropiane, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe njohurive mbi menaxhimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të UKZ-së. Kjo paraqet një përparësi të madhe për të qenë në trend me zhvillimin e ideve, caktimin e prioritetëve shkencorë ndërkombëtarë dhe mundësinë për të reprezentuar idetë dhe projektet e UKZ-së në nivel rajonal.

UKZ është njëri prej themeluesve të Asociacionit të Universiteteve Ballkanike (Ballkan University Association, BUA). Është po ashtu anëtar i Asociacionit për Edukimin e Mësuesve në Evropë (ATEE), anëtar i Forumit të Rektorëve të Ballkanit Perëndimor dhe Europës Jug-Lindore, anëtare themeluese e Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike të Kosovës.

Duhet të bëhen kërkesa për anëtarësim edhe në asociacione të tjera të universiteteve.

7.5. **Pjesëmarrja në projektet e Erasmus+ dhe projekte të tjera ndërkombëtare.** UKZ aktualisht është e përfshirë në disa programe të Erasmus+, si: REBUS, EUFORIA, GREEN TECH. UKZ duhet të fokusohet në këso programesh. Programet e tilla ofrojnë

fonde për zhvillime shkencore formale dhe joformale. Ne duhet të synojmë që të përfshihemi në shumicën e këtyre projekteve që përfshijnë Ballkanin Perëndimor dhe si të tillë të zhvillojmë programe studimi dhe bashkëpunime të rëndësishme për studentët dhe stafin.

7.6. Krijimi i programeve në gjuhë të huaja. Krijimi i programeve baçelor dhe master në gjuhën angleze do të ndihmonte edhe më tepër ndërkombëtarizimin e UKZ- së, duke e bërë pjesë të barabartë në projektet ndërkombëtare.

7.7. Programi GUEST SPEAKER. Ky program ofron një mundësi të mirë që studentytë dhe stafi akademik të njoftohen me të arriturat kulminante jetësore e profesionale të individëve, në të gjitha fushat, dhe nga të gjitha vendet e botës.

7.8. Të bëhen shkëmbime shkencore. Nxitja e shkëmbimit të arriturave shkencore ndërmjet UKZ dhe universiteteve partnere.

7.9. Mobiliteti i stafit akademik. Mobiliteti i stafit akademik konsiderohet shumë i rëndësishëm për të shkëmbyer dhe përfituar përvoja të reja, shkathtësi menaxheriale, aftësi hulumtuese dhe njohuri për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të universitetit.

8. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS ADMINISTRATIVE, HAPSINORE, FINANCIARE DHE TË IT

9.1. Nxjerrja e akteve administrative që burojnë nga Statuti i UKZ i miratuar në Kuvendin e Kosovës më 10.12.2020 dhe përputhja e akteve të vjetra me këtë Statut.

9.2. Pavarësimi financiar nga MASH. UKZ synon pavarësim të plotë nga MASHT, në raport me prokurimin dhe financat, në mënyrë që t'u shmanget procedurave burokratike të cilat prolongojnë implementimin e projekteve të planifikuara. Në këtë aspekt, UKZ do të rekrutojë staf mbështetës civil për të plotësuar pozitat vakante, duke u krijuar si organizatë e pavarur buxhetore.

9.2. Kampusi i ri. UKZ e ka kampusin e saj në qendër të qytetit të Gjilanit, mirëpo i cili nuk i plotëson të gjitha kushtet për mbarëvajtje të punës dhe aktivitetit mësimor, prandaj duhet kërkuar edhe një zgjidhje tjetër. Ndërtimi i kampusit të ri universitar është nevojë imediate e UKZ-së për të krijuar mjedis të favorshëm për punë, studime dhe hulumtime. Kuvendi i Komunës së Gjilanit, me vendim nr. 01/45809 të dt. 27.05.2013, ka miratuar planin rregullues të Komunës në të cilin UKZ-së i ndahet një parcelë prej 7.3 ha për ndërtimin e Kampusit Universitar. Qeveria e Kosovës me vendimin nr.01/19 të dt. 15.12.2017, ka aprovuar kërkesën e UKZ-së për ndërtimin e Kampusit bazuar në vendimin e KK Gjilan.

Menaxhmenti i UKZ-së, qeveria së bashku me komunën e Gjilanit vazhdimisht bëjnë përpjekje për realizimin e kampusit të ri.

UKZ synon të themeloj Muzeun Universitar për të mbrojtur, ruajtur dhe kultivuar vlerat e krijuara. Realizimi i disa pejë këtyre projekteve do të jetësohet me ndërtimin e kampusit të ri universitar.

9.3. Të zhvillohet digjitalizimi i procesit të mësimin. UKZ në vazhdimësi përkrahë dhe shtyn tutje aplikimin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe hulumtimit. Aktualisht jemi në proces të adaptimit të programit të moduleve, ku kjo platformë pritet të lehtësojë dhe avancojë komunikimin e profesoriatit me studentët dhe do

të ofrojë mundësi reale drejt përmirësimit të cilësisë. Në këtë aspekt, pritet të bëhet digjitalizimi i mëtutjeshëm i procesit mësimor, si dhe mundësia e zbatimit të *e-learning*. UKZ synon zhvillimin e mëtutjeshëm të SMU-së dhe shërbimeve të tjera elektronike në përkrahje të studentëve, stafit akademik, menaxhmentit, administratës dhe institucioneve tjera të interesuara.

9.4. Të pasurohet dhe të digjitalizohet Biblioteka Universitare. UKZ ka për objektiv të rritjen e numrit të librave dhe revistave shkencore, duke përfshirë hapësirën e nevojshme, librat dhe materialet bashkëkohore, të cilat përkojnë me objektivat zhvillimore të procesit mësimor dhe të shkencës, në mënyrë që studentët tanë të jenë konkurrues me studentët të nivelit evropian dhe me gjerë. Biblioteka pritet të digjitalizohet, ku në mënyrë elektronike automatikisht përmes sistemit do të dihet numri i librave universitare në dispozicion për huazim, përdorimi i librave nga ana e studentëve, si dhe llogaridhënia mbi vendndodhjen e saktë të librave. Biblioteka e UKZ ndërlidhet me Bibliotekën Kombëtare Universitare.

9.5. Zhvillimi i mëtejshëm i Laboratorëve. UKZ aktualisht ka disa laborator mirëpo gjithnjë nxit themelimin e laboratorëve të tjerë dhe pajisjen e tyre me teknologjinë moderne. Për të ndihmuar në procesin e mësimdhënies dhe për të nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve shkencore që kemi në dispozicion.

9.6. Të themelohet Muzeu i UKZ. Për të ruajtur dhe krijuar traditën e vet, UKZ të themelojë Muzeun e UKZ.

9.7. Të krijohet Këndi i Erasmus+. Meqenëse UKZ është orientuar shumë kah projektet ndërkombëtare, sidomos kah Erasmus+, në një kënd të objektit të themelohet Këndi i Erasmus+.

9.8. Të krijohet Këndi Amerikan. Meqenëse UKZ bashkëpunon ngusht me institucionet dhe zyrat e ndryshme të SHBA, si USAID, Ambasada Amerikane në Kosovë, University of Ohio, James Madison University etj., në një kënd të objektit të themelohet Këndi Amerikan i Kulturës.

10. FINANCIMI

10.1. Stabiliteti financiar

UKZ ka një stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare afatgjatë, pasi si universitet publik financohet prej buxhetit të Republikës së Kosovës. Granti qeveritar është fond i lejuar nga buxheti i Kosovës, i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e UKZ-së ky burim financon aktivitetet që kanë të bëjnë me kategoritë si në vijim:

- Pagat dhe mëditjet,
- Mallrat dhe shërbimet,
- Komunalitë,
- Subvencionet,
- Shpenzimet kapitale.

Granti qeveritar për vitet 2020/2021/2022 i shprehur në shifra:

<i>Kategoritë e Buxhetit</i>	<i>Viti 2021 - aprovuar</i>	<i>Viti 2022 - vlerësuar</i>	<i>Viti 2023 - vlerësuar</i>
Pagat dhe Meditjet	1,297,643.00 €	1,297,643.00 €	1,347,423.00 €
Mallrat dhe Shërbimet	400,000.00 €	347,998.00 €	347,998.00 €
Shpenzimet komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet	100,000.00 €	100,000.00 €	100,000.00 €
Shpenzimet Kapitale	700,000.00 €	1,200,000.00 €	1,200,000.00 €
TOTAL:	2,547,643.00 €	2,995,641.00 €	3,045,421.00 €

Tabela nr. 5: Buxheti tre vjecar i UKZ i projektuar. (Qeveria e Kosovës)

UKZ, nga viti në vit ka shënuar një rritje të lehtë të buxhetit në saje të grantit qeveritar. Kështu që, më poshtë po japim të dhënat historike për shumën e buxhetit për vitin 2018, 2019 dhe 2020.

<i>Kategoritë Ekonomike</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>
Paga dhe Shtesa	1,130,240.00 €	1,183,782.56 €	1,183,783.00 €
Mallra dhe Sherbime	316,339.00 €	316,339.00 €	316,339.00 €
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Subvencione dhe Transfere	30,000.00 €	100,000.00 €	100,000.00 €
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	600,000.00 €	600,000.00 €	650,000.00 €
Totali	2,126,553.00 €	2,250,121.56 €	2,300,122.00 €

Tabela nr. 6: Buxheti tre vjecar i UKZ i realizuar. (Qeveria e Kosovës)

Megjithë stabilitetit financiar, UKZ ka nevojë për më shumë fonde nga Qeveria e Kosovës. Në tabelën e mëposhtme shihen kërkesat shtesë për financa për vitin 2021-23:

	<i>2021 Vlerësimi</i>	<i>2022 Vlerësimi</i>	<i>2023 Vlerësimi</i>
Total	2,680,800.00	2,737,000.00	2,833,200.00
Numri i punëtorëve	18	20	22
Paga dhe meditje	280,800.00	312,000.00	343,200.00
Mallra dhe sherbime	200,000.00	235,000.00	290,000.00

Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	60,000.00	70,000.00	80,000.00
Shpenzime kapitale	2,140,000.00	2,120,000.00	2,120,000.00
Burimet e financimit			
Totali	2,680,800.00	2,737,000.00	2,833,200.00

Tabela nr. 7: Kërkesat e UKZ për buxhet shtesë ndaj Qeverisë së Kosovës. (UKZ)

10.2.Rritja e të hyrave vetanake. UKZ, si burim suplementar të të hyrave ka edhe taksat e studentëve. Pagesat e studentëve aktualisht janë fikse për të gjithë bartësit publikë të licencuar dhe të akredituar të arsimit të lartë. Taksat e studenteve rregullohen sipas udhëzimit administrativ të nxjerrur nga MASH, nr. 17/2014, për aplikimin e pagesave të studentëve në universitetet publike.

10.3.Kërkimet shkencore dhe projektet. UKZ një rol të rëndësishëm do t’ia kushtojë edhe kërkimeve shkencore në gjenerimin e të hyrave vetanake. Të ardhurat nga kërkimet e publikimeve shkencore do të konsiderohen si një burim i rëndësishëm i financimit të një pjese të aktiviteteve të UKZ-së.

10.4.Partneriteti publik-privat. Dinamika e tregut të shekullit XXI ka njohur një burim të ri financimi dhe efikas për projektet publike, posaçërisht projekteve me rëndësi strategjike. Ky burim i ri i financimit të UKZ-së do të bazohet kryesisht tek partneriteti mes sektorit publik – UKZ-së dhe partnerëve tanë privatë. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy sektorëve, do të mund të gjente zbatim në disa fusha të rëndësishme si: bashkëpunimi në projektet në fushën e financimit (koncesionimit, qirasë), ndërtimit, menaxhimit, mirëmbajtjes, shërbimit etj.

Partneriteti publik-privat i UKZ-së do të sigurojë një qasje shtesë dhe më të madhe në burime alternative, duke përdorur burimet teknike, njerëzore, fizike, financiare të të gjithë sektorëve.

10.5.Donacionet. Strategjia e financimit të UKZ-së do të mbështetet edhe në tërheqjen e donacioneve - projekteve të ndryshme. Donacionet do të thellojnë edhe më shumë zhvillimin dhe stabilitetin financiar të UKZ-së. Në saje të kësaj, anëtarësimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe aplikimi në projekte të ndryshme të Bashkimit Evropian do të sigurojë mjete shtesë për UKZ-në.

10.6.Të hyrat e tjera. Të hyrat e tilla nuk i kemi parashikuar në planin e të hyrave vetanake të UKZ-së. Këto mund të jenë kryesisht të hyra të cilat do të mund të gjeneroheshin jashtë institucionit dhe që nuk përfshihen në kategoritë e analizuara më sipër.

Realizimi dhe planifikimi i të hyrave për vitet 2019-2021					
<i>Përshkrimi</i>	Të hyrat 2018	Të hyrat 2019	Të hyrat 2020- <i>projekcion</i>	Totali 2021- <i>projekcion</i>	Totali 2022- <i>projekcion</i>
<i>Totali vjetor i të hyrave</i>	135,742.00€	129,737.20€	124,187.00€	124,187.00€	124,187.00€

Tabela nr. 8: Të hyrat vetanake 2018/2019/2020 (UKZ)

10.7.Një pjesë e të hyrave në UKZ realizohet prej projekteve ndërkombëtare. Në këtë pikë UKZ duhet të investojë më shumë sepse këto fonde janë një burim i madh për projekte hulumtuese dhe ndikojnë drejtpërdrejt në thellimin e hulumtimit shkencor dhe në standardizimin e zhvillimit akademik de të procesit hulumtues me rrjedhat ndërkombëtare.

Akronimi	Emri	Koordinator	Buxheti	Afati i kontratës
QUADIC	Quality development of international cooperation and project management (Ngritja e kapaciteteve në bashkëpunim ndërkombëtar dhe menaxhim të projekteve	Universiteti "Kadri Zeka"	991,381.00 €	36 muaj 15/01/2020 15/01/2023
STAND				
SIAHDPC				
STEAMEDu				
e-VIVA	Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Eastern Balkan Universities - Ngritja dhe validimi i kompetencave në shërbim	Universiteti Evropian i Tiranës	56,075.00 €	36 muaj 15/11/2018 15/11/2021
SMAHPC	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center -Krijimi I Qendrës Multidisciplinare për studentë	Kolegji Heimerer	73,115.00 €	36 muaj 15/11/2018 15/1/2021
ResearchCult	Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo Ngritja e kulturës së hulumtimit në IAL në Kosovë	Kolegji IBCM	53,440.00 €	36 muaj 15/11/2019 15/1/2022
	Legal clinics in service of vulnerable groups: enhancing the employability of Iaë			36 muaj

ENEMLOS	students through practical education Ngritja dhe funksionalizimi I Klinikave Ligjore Në universitetet partnere përmes edukimit në praktikë	Universiteti i Podgoricës	90,586.00 €	15/11/2019 15/11/2022
QATEK	Toëards a quality-oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo” Ngritja e cilësisë së mësimin tek stafi dhe studentët në fakultetet e edukimit	Universiteti i Prishtinës	95,865.00 €	36 muaj 15/11/2019/15/11/2022
Rebus	Integrating And Validating Practical entrepreneurship skills in engineering and ICT studies – REBUS	Universiteti i Sarajevës	78,498.00	36 Muaj 24/01/2017/30/11/2020
GreenTechWB				
EUFORIA				
Totali			1,438,960.00	

Tabela nr. 9: Të hyrat nga projektet ndërkombëtare (2018, 2019, 2020). (UKZ)

10.8.Objektivat e avancimi i planit financiar. Objektivi i planit financiar të UKZ-së konsiston në rritjen e të hyrave dhe stabilitetit financiar me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve akademike dhe infrastrukturore të saj. Këtë do ta bëjmë përmes rritjes së efikasitetit në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve tona njerëzore dhe financiare, si dhe rritjes së të hyrave në saje të aktiviteteve fitimprurëse të UKZ-së: kërkimeve shkencore, partenritetet publik-privat, donacioneve etj.

Në kuadër të objektivave do të bëhet:

- Projektimi i të hyrave,
- Plani i shpenzimeve.

10.9.Investimet strategjike. UKZ do t'i orientojë investimet kapitale në dy drejtime kryesore:

- I. Investimet në burime njerëzore:
 - a) Rritja dhe avancimi i njohurive të stafit
 - b) Rritja e numrit të punetoreve
 - c) Zhvillimi i trajnimeve
 - d) Rritja e performancës
- II. Investimet në infrastrukturë:

- a) Ndërtimi i Kampusit të ri universitar/renovimi dhe shtimi i kampusit aktual;
- b) Modernizimi i infrastrukturës fizike – teknologjike, laboratore dhe
- c) Investimi në paisje të reja bashkëkohore

Më poshtë është tabela me orientimin e buxhetit në përputhje me objektivat strategjike të UKZ:

Nr.	Kategoria	Shuma	Perqindja
1	Burimet njerëzore	1,343,879.55 €	75.22%
2	Infrastruktura	295,433.70 €	16.54%
3	Puna kerkimore shkencore	1,651.92 €	2.45%
4	Projektet Nderkombetare	43,860.39 €	2.45%
5	Bashkepunimi nderkombetar	20,969.00 €	1.17%
6	Studentet	80,897.15 €	4.53%
	Totali	1,786,691.71	100%

Tabela nr. 10: Orientimi i buxhetit drejt objektivave strategjike. (UKZ).

10.10. Llogaridhënia – auditi. Ndërtimi i një sistemi financiar efikas, i bazuar në transparencë, llogaridhënie dhe kontrollë konsiderohet si njëra ndër objektivat kryesore financiare të UKZ-së. Në këtë fushë, pyetjet që kërkojnë përgjigje janë:

- a) Si është shpenzuar buxheti i UKZ-së në bazë të kategorive kryesore dhe a po arrihen objektivat e përcaktuara me planifikim buxhetor?
- b) A është i mjaftueshëm buxheti për kryerjen e aktiviteteve në Universitet brenda vitit të caktuar fiskal dhe a kemi nevojë për rishikime?
- c) Çfarë ka raportuar Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese gjatë planit të veprimit?

10.11. Raportet periodike. Raportet financiare të UKZ-së do të paraqesin aktivitetin financiar të institucionit, ashtu siç është specifikuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048) ku përfshihen të gjitha organizatat buxhetore, MASHT-i dhe si nënprogramet e saj. Menaxhimi i parasë në UKZ bëhet përmes llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollojnë një institucion i vetëm - pra Thesari.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në raportet financiare do të paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme.

Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, çdo organizatë buxhetore duhet t'i dorëzojë Ministrin një raport vjetor për vitin e kaluar fiskal. Ky raport duhet të përfshijë raportimin mbi veprimtarinë e organizatës buxhetore, duke përfshirë një Deklaratë të Rezultateve në të cilën identifikohen arritjet (rezultatet) kundrejt planit të veprimit.

Gjithashtu, UKZ në baza të rregullta 3 mujore raporton për shpenzimet financiare në Këshillin Drejtues – si organi më i lartë qeverisës i universitetit duke paraqitur shkallën e realizimit të buxhetit dhe sfidat për vitin raportues.

KAPITULLI VII

Monitorimi dhe raportimi

Për zbatimin e Planit Strategjik 2017-2022 UKZ do të përditësojë çdo fillim-vit kalendarik Planin e Veprimit. Plani i Veprimit përmban aktivitetet që do të jenë në përmbushje të Objektivave Strategjike dhe Specifike. PV do ta hartojë një grup i caktuar nga Këshilli Drejtues në koordinim me Rektorin dhe do të miratohet në KD. Monitorimi i zbatimit dhe raportimi do të bëhet nga Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Planit Strategjik. Ky komision themelohet sipas Rregullores për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik, të nënshkruar nga Rektori dhe do të përbëhet nga drejtuesit e fakulteteve që përcjellin për së afërmi dinamikën zhvillimore nëpër fakultetet përkatëse, Sekretari i Përgjithshëm që menaxhon administratën e universitetit, përfaqësues nga Këshilli Drejtues dhe Rektorati. Rregullorja për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik përcakton qartë përbërjen e grupit, rolet dhe përgjegjësitë dhe procesin e raportimit.

Duke qenë se UKZ gjendet në një fazë tejet intensive siç është akreditimi institucional, dhe programeve të ndryshme si dhe dinamika tjera që lidhen me to para dhe pas aplikimit për akreditim, raportimi i zbatimit të Planit Strategjik do të bëhet në bazë 6 mujore, vjetore dhe raportimi i përgjithëm për vlerësimin e zbatimit të Planit Strategjik, i cili do të bëhet në vitin 2022 kur edhe përfundon afati i zbatimit të këtij plani. Një vlerësim (evaluim) i zbatimit të Planit Strategjik do të bëhet në vitin/apo pas vitit të fundit të strategjisë.

Raporti 6 mujor bëhet për të monitoruar progresin e zbatimit të planit duke dhënë një pasqyrë të asaj se çfarë është arritur e çfarë jo, çfarë duhet ndërmarrë për të rritur dinamikën aty ku ka vështirësi që ngadalësojnë ritmet. Raporti gjashtë mujor përgaditet deri në fund të korrikut për gjashtë mujorin e parë të vitit përkatës. Ndërsa periudha e gjashtë mujore e pjesës së dytë të vitit mbulohet me raportin vjetor të atij viti. Fokusi i raportit është në arritjen e afateve të aktiviteteve siç parashihet në planin e veprimit, arsyet për vonesa, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve dhe hapat e ardhshëm.

Qëllimi i Raportit vjetor është të vlerësojë progresin e zbatimit të Planit Strategjik të UKZ-së kundrejt çdo Objektivave Strategjike dhe Specifike, duke përdorur informatat mbi zbatueshmërinë dhe eventualisht moszbatueshmërinë e aktiviteteve të planifikuara. Raportit vjetore do të përmbajnë analiza krahasuese mbi progresin e bërë kundrejt viteve paraprake. Përpos progresit të arritur gjatë vitit të raportimit raporti do të përmbajë informata nëse janë zbatuar me kohë aktivitetet e planifikuara, përdorimi i burimeve financiare, pengesat dhe sfidat për zbatim dhe propozimin e masave për tejkalimin e tyre. Raporti vjetor do të përgaditet gjatë tre mujorit të vitit vijues.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik do të sigurohet që gjatë fazës së zbatimit të Planit Strategjik të minimizojë nëse jo të eliminojë tërësisht çfarëdo vështirësi apo sfide që potencialisht do të mund të vështirësonte përmbushjen e Objektivave Strategjike.